

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, me gjyqtaren Naime Ahmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditësit N.N N.P.Z. "R.F" me seli në P, Rruga e P, pn, me pronar F.R, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit A.B avokat nga P, kundër të paditurit B.H nga P, Rruga M.S, nr., për borxh në vlerë prej 24.675,00 €, në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur në prani të autorizuarit të paditësit e në mungesë të paditurit, me dt. 15.11.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit N.N N.P.Z. "R.F" me seli në P, me pronar F.R nga P. dhe Detyrohet i padituri B.H nga P, që paditësit në emër të borxhit t'ia paguaj shumën prej 24.675,00 €, me kamatë në lartësi të cilën e paguajnë bankat vendore si për mjetet e afatizuara për një vit, pa destinim të caktuar duke filluar prej datës 15.11.2017, e deri në pagesën e plotë si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 618.40 €, në afat prej 15 ditësh nga marrja e aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësi përmes përfaqësuesit të autorizuar të tij në padi, në seancën e shqyrtimit kryesor, si dhe në fjalën përfundimtare ka kërkuar që të obligohet i padituri që paditësit t'ia paguan borxhin e mbetur në shumën prej 24.675,00 € së bashku me kamatën përkatëse ligjore, sipas kontratës për Ndërtim Nr. 12 dt. 18.06.2002, për kryerjen e punëve ndërtimore në objektin e të paditurit i cili gjendet në Lagjen S. në P, Rruga Sh.R, pn, gjegjësisht shtëpina e cila është pronë e të paditurit. Më tej ka theksuar se qmimi kontraktues ka qenë 32,324.50 €, ndërsa që paditësi me të paditurin kanë kontraktuar edhe punë shtesë në vazhdimësi nga kontrata nr. 12 e dt. 12.06.2002 në shumë prej 38.676,00 €. Mirëpo i padituri ka mbetë borxh paditësit në shumën si më lartë, të cilën asnjëherë nuk e ka kontestuar, por ka kërkuar afat shtesë që të paguhet borxhi, mbi këtë bazë i ka propozuar gjykatës që të marrë vendim merititor dhe ta aprovoj kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar duke e detyruar të paditurin në pagimin e borxhit të mbetur në shumë prej 24.675,00 €, me kamatë, në lartësi të cilën e paguajnë bankat vendore si për mjetet e afatizuara për një vit, pa destinim të caktuar.

Shpenzimet e procedurës i kërkoi.

I padituri ka qenë i ftuar me raport nëpërmes lajmërimit që në afat prej 15 ditëve të vij në gjykatë dhe të marrë thirrjen, mirëpo meqenëse i njëjti nuk ka ardhë dhe nuk e ka marrë ftesën, ftesa i është lënë në derë i cili konsiderohet dorëzim i rregullt konform neneit 115 të LPK, mirëpo në seancën e shqyrtimit kryesor me dt. 15.11.2017 ka munguar dhe mungesën nuk e ka arsyetuar, prandaj gjykata me propozimin e paditësit dhe konform neneit 423.4 të LPK-së, shqyrtimin kryesor e ka mbajtur në mungesë të të paditurit.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor - publik të dt. 15.11.2017, bëri administrimin e provave relevante materiale dhe atë; qertifikatën e biznesit me nr. ... N.P.Z. R.F P, kontratën nr. 12 dt. 18.06.2002, ofertën për punët ndërtimore dt. 16.06.2002, oferta për punët e gjetimit dhe lysterjes dt. 11.04.2002 dhe oferta për punët shtesë në shtëpinë individuale në S. dt. 02.06.2003.

Pasi që Gjkata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për procedurën Kontestimore, arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike kontestimore duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Sipas kontratës nr.12 e dt. 18.06.2002 është lidh kontrata për ndërtim në mes të paditësit në njërën anë si punëkryes dhe të paditurit në anën tjetër si investitor, për kryerjen e punëve ndërtimore në objektin në S. pronë e të paditurit, për çmim kontraktues prej 32,324.50 €.

Nga qertifikatën e biznesit me nr..., vërtetohet se paditësi është i regjistruar pranë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, përkatësisht Agjencioni i Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë, me emrin N.P.Z. R.F P, me dt. 03.10.2000.

Me ofertën e dt. 11.04.2002, vërtetohet se paditësi ka kryer punët ndërtimore në shtëpinë individuale të paditësit në vlerë prej 30,325.00 €, ndërsa me ofertën e dt. 16.06.2002 vërtetohet se janë kryer punët ndërtimore në vlerë prej 32,324.50 €.

Me ofertën e dt. 14.09.2002 shihet se janë kryer punë ndërtimore në vlerë prej 13,621.50 €, ndërsa me ofertën e dt. 02.06.2003 shihet se janë kryer punët ndërtimore në vlerë prej 10,000.00 €, gjykata ka vërtetuar se në mes të palëve ndërgjyqëse në bazë të ofertave për punët e kryera, ka pas mardhënie kontraktuale ku paditësi me të paditurin janë barazuar me disa nga borxhet që kanë rrjedhë me ofertat si më lartë, mirëpo që borxhi si në padi, nga i padituri ka mbetur i pa paguar në shumë prej 24.675,00 €.

I padituri nuk ka paraqitur përgjigje në padi dhe as nuk ka prezantuar në seancën e shqyrtimit kryesor. Gjkata vlerëson se i padituri nuk ka prezantuar kurrfarë prova relevante me çka do të argumentonte të kundërtën nga ajo çka pretendon paditësi.

Nga kjo rezulton se i padituri në emër të kryerjes së punëve ndërtimore në shtëpinë e tij e cila gjendet në S, i ka mbetur borxh paditësit në shumë e aprovuar si në padi dhe kërkesë padinë e paditësit.

Pasi që gjykata ka konstatuar këtë gjendje faktike ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit pasi që i padituri nuk ka ushtruar përgjigje në padi dhe as nuk ka marë pjesë në sanca gjyqësore që të argumentonte të kundërtën.

Sipas nenit 262 par. 1 i Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, kreditori në marrëdhënien detyrimore është i autorizuar që nga debitori të kërkoj përmbushjen e detyrimit kurse debitori është detyruar që ta përmbushë detyrimin me ndërgjegje dhe në tërësi siç kanë paraparë, me parë, ndërsa me dispozitën e nenit 148.par1 të LMD-së është përcaktuar se „kontrata krijon të drejta dhe detyrime për palët kontraktuese” ky përcaktim është i natyrshëm dhe i pranueshëm edhe në rastin konkret pasi që në rastin konkret palët

kontraktuese me marrëveshje e kanë përcaktuar objektin e kontratës të drejtat, detyrimet dhe efektet.

Meqenëse i padituri ka rënë në vonesë për kthimin e borxhit, gjykata me kërkesën e paditësit dhe në bazë të nenit 277 par.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, e detyroi të paditurin që paditësit shumë e gjykuar t'ia paguaj edhe kamatën, jo nga dita e ushtrimit të padisë por sipas mjeteve të deponuara mbi një vit në bankat komerciale vendore pa destinim të caktuar, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit, atëherë edhe kur është shqyrtuar kërkesa e paditësit me të cilën është konstatuar borxhi i pretenduar, të gjitha deri në pagesën definitive.

Vendimi që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në dispozitën e nenit 450 dhe 452 e LPK-së, dhe atë paditësi i janë njohur shpenzimet për përpilim të padisë në shumë prej 208 €, për taksë gjyqësore për padi shuma prej 140 € dhe për përfaqësim seancës shqyrtimit kryesor shuma prej 270,40 €.

Mbi bazën e te dhënave si me lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
C.nr. 148/07 me dt.15.11.2017

G j y q t a r j a,
Naime Ahmeti

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate.